

# SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**OVAL**

---

## AKTI I THEMELIMIT

---

Në Tiranë, sot në datën 03.11.2023, themeluesi i mëposhtëm, shtetasi:

- **Eri Kokalari**, lindur me 17.12.1987, në Tirane, banues në Tiranë, Shtetas Shqiptar, me numër personal I81217060N madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

### **I. Themelimi**

Vendosi themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**OVAL**” **sh.p.k** (“Shoqëria”), bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar). Ortaku ka vendosur për të zhvilluar me vullnetin e tij të lirë veprimtari tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë, si dhe me çdo vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë. Shoqëria do të ushtrojë veprimtari tregtare për një kohëzgjatje të pacaktuar.

### **II. Selia**

Selia e shoqërisë është në adresën: Njësia Administrative Nr.10, Rruga e Kavajës, Pallati Nr.133, Apartamenti Nr.7, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

### **III. Objekti**

**1.1.** Shoqëria mund të ndërmarrë veprimtaritë e mëposhtme tregtare:

**1.1.1.** Ndërtim i programeve kompjuterike (software development), arkitekturë dhe mirmbajtjen e rrjeteve kompjuterike, ndërtim faqesh interneti, ofrimin e shërbimeve së këshillimit në fushën e elektronikës dhe programimit, ofrimin e shërbimeve të internetit dhe cdo lloj aktivitei mbështes për teknologjine e informacionit.

**1.1.2.** Shërbime marketingu, dizenjimi dhe organizim eventesh. Organizim fushatash promovuese dhe panairesh, printime promocionale dhe idemime dhe xhirime rreklamash.

**1.1.3.** Shitblerjen me shumicë e pakicë të paisjeve kompjuterike (hardware) dhe programeve kompjuterike (software) si dhe rishitjen e tyre, përfaqësimin e operatoreve të huaj dhe ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes.

Oval sh.p.k

Akti i themelimit

Datë 03.11.2023

- 1.1.4.** Kurse trajnimi në fushën e teknologjisë
- 1.1.5.** Këshillimi financiar dhe tregtarë si dhe këshillime dhe studime në çdo fushë ku shoqëria gëzon ekspertiza të nevojshme, veçanërisht këshillim në fushën e së drejtës tregtare, taksave, prokurimeve publike, koncesionet dhe privatizimet, pronësinë intelektuale dhe të drejtat e autorit, fushatave të marketingut e studimeve të tregut.
- 1.1.6.** Përfaqësimi i shoqërive tregtare, individëve apo çdo entiteti tjetër me personalitet juridik në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj.
- 1.1.7.** Veprmitari ndertimore duke përfshirë por pa u limituar në ndertime komerciale dhe banimi, financim i projekteve ndertimore, ndertim infrastrukturë rrugore dhe toksore, detare, ajrore dhe hekurudhore.
- 1.1.8.** Këshillime financiare, bankare dhe tregtare veçanërisht në fushën e investimeve të huaja, në telekomunikacion dhe energji, në fushën e turizmit dhe ndërtimit si dhe në çdo fushë tjetër që shoqëria e çmon të nevojshme dhe të përshtatshme.
- 1.1.9.** Kryerja e çdo lloj aktiviteti që lidhet me veprimtarinë e agentit, brokerit, komisionerit, ndërmjetësit pa u kufizuar nga veprimtaria që kryhet nga porositësi apo çdo palë tjetër e tretë.
- 1.1.10.** Shfrytëzimin ekonomik në çdo lloj forme të teknologjive, dizenjove, markave, licencave, produkteve, pamjeve grafike si dhe çdo produkti tjetër.
- 1.1.11.** Kryerjen e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit si pjesë e projekteve që sjellin risi ligjore, ekonomike, financiare apo teknologjike, të kryera me qëllim përfitimin e financimeve apo komisioneve nga palët e treta.
- 1.1.12.** Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria ka të drejtë:
- 1.1.13.** të mundësojë trajnime profesionale për punëmarrësit e saj apo palë të treta;

- 1.1.14.** të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë;
- 1.1.15.** të kryejë çdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin;
- 1.1.16.** të zotërojë kuota/aksione apo çdo lloj interesi tjetër në shoqëri të tjera, pavarësisht fushës në të cilën kryejnë veprimtari këto shoqëri.
- 1.1.17.** Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.

Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës

#### **IV. Statuti**

Ortaku Themelues ka rënë dakort për miratimin e statutit të shoqërisë sipas tekstit bashkëlidhur këtij akti themelimi të nënshkruar rregullisht nga Ortaku.

#### **V. Kapitali i regjistruar**

Vlera e Kapitalit të regjistruar të shoqërisë është **100.000 (njëqind mijë) Lek**. Kapitali ndahet në **1 kuotë**, me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lek, të nënshkruar dhe të shlyer plotësisht nga Ortakët themelues si më poshtë vijon:

**Eri Kokalari** – zotërues i 1 Kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lek, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar.

#### **VI. Administratori**

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator, të Drejtat dhe Detyrimet e të cilit janë të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, në Statutin e Shoqërisë si dhe në Aktin e Emerimit të tij.

Administrator i Shoqërisë është:

Të dhënat e identifikimit	Specimeni i nënshkrimit
<b>Eri Kokalari</b> , lindur me 17.12.1987, në Tiranë, banues në Tiranë, Shtetas Shqiptar, me numër personal I81217060N madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar	

Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit është për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore, me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori vepron individualisht dhe si firmëtar i vetëm në lidhje me çdo çështje të Shoqërisë e cila i është caktuar shprehimisht ose në rast se nuk i është përcaktuar shprehimisht, çdo çështje që përfshihet në administrimin e zakonshëm të shoqërisë.

Me datën 03.11.2023, në Tiranë, u hartua dhe u nënshkrua, me vullnetin e lire të Ortakëtt themelues, ky Akt Themelimi i Shoqërisë “**OVAL**” sh.p.k., në 2 kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njejtë ligjore.

**PËR SHOQËRINË**

**“OVAL” sh.p.k**

**ORTAKU THEMELUES**

## ERI KOKALARI

---